



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 182, datë 27.07.2020

PËR MOSPRANIMIN E ANKIMIT

Në mbështetje të nenit 49 të Ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 189 të Ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë pasi u njoh me ankesën e znj. Erida Visoçi, prokurore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, kundër vendimit të Drejtuesit të Prokurorisë “Për krijimin e grupit hetimor” të datës 15.04.2020, paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nëpërmjet kërkesës së regjistruar me nr.883 prot datë 20.07.2020,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankimit (kundërshtimit) të znj. Erida Visoçi në lidhje me Vendimin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë “Për krijimin e grupit hetimor” të datës 15.04.2020.
2. Të njoftohet për këtë vendim znj. Erida Visoçi dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI  
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETARI  
ALFRED BALLA

ANËTAR  
KOSTAQ BELURI

ANËTAR  
BUJAR SHESHI

ANËTAR  
NURIHAN SEITI

ANËTAR  
SANDËR BECI

ANËTAR  
VATË STAKA

ANËTAR  
TARTAR BAZAJ

ANËTAR  
ESMERALDA KESHI

